



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

Avokati i Popullit,

Mbështetur në nenin 37 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.16/26, qershor 2015, Prishtinë),

nxjerr:

KODIN E ETIKËS NR 01/2023 TË INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Kodi i Etikës i Institucionit të Avokatit të Popullit (në tekstin e mëtejme: Kodi) përcakton parimet dhe rregullat me të cilat rregullohet sjellja e të punësuarve në Institucionin e Avokatit të Popullit (në tekstin e mëtejme: IAP) në ushtrimin e detyrës dhe jashtë saj, me qëllim të respektimit të misionit dhe ruajtjes së autoritetit të IAP-së.

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Dispozitat e këtij Kodi zbatohen ndaj të punësuarve në IAP.
2. Dispozitat e këtij Kodi përshtatshëmrisht zbatohen edhe për zëvendësit e Avokatit të Popullit, për stafin e kabinetit të Avokatit të Popullit, për ekspertët e jashtëm dhe për praktikantët.

**Neni 3
Përkufizimet**

Për qëllime të këtij Kodi, termi “i/e punësuar” nënkupton personelin sipas Ligjit për Avokatin e Popullit dhe të akteve nënligjore të IAP-së.

Neni 4

Parimet themelore

1. I punësuari duhet t'i mbajë në konsideratë parimet, por pa u kufizuar vetëm në:
 - 1.1. integritet;
 - 1.2. ligjshmëri;
 - 1.3. paanshmëri dhe pavarësi;
 - 1.4. konfidencialitet;
 - 1.5. transparencë.

Neni 5

Integriteti

I punësuari duhet të ketë standarde të larta të integritetit personal dhe profesional, duke përfshirë këtu ndershmërinë, sinqeritetin dhe drejtësinë. I punësuari duhet ta shprehë në mënyrë besnike të vërtetën, pa frikë dhe pa u ndikuar nga pikëpamjet e bindjet politike, sociale, fetare apo ekonomike të personave që takon gjatë ushtrimit të detyrës. Gjithashtu, i punësuari duhet ta ruajë të pastër figurën e tij/saj morale dhe të shmang sjellje apo veprime të cilat cenojnë autoritetin dhe imazhin e IAP-së, para opinionit publik.

Neni 6

Ligjshmëria

I punësuari kryen detyrat e tij me ndërgjegje, ndershmëri dhe në mënyrë të paanshme, në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin. Është detyrë e të punësuarit që me zbatimin e Kushtetutës, të ligjit dhe të akteve nënligjore të arrihet shkalla më e lartë e mundshme e sigurisë juridike/ligjore, e objektivitetit, e besimit si dhe evitimi i çdo lloj situatë e cila mund të shkaktojë dëm në imazhin e IAP-së.

Neni 7

Paanshmëria dhe pavarësia

I punësuari duhet t'i kryejë detyrat e tij në mënyrë të paanshme, të pavarur, objektive dhe me profesionalizëm, si dhe të mos ndikohet nga ndërhyrjet e brendshme dhe të jashtme. Gjithashtu, i punësuari duhet ta marrë parasysh dhe në mënyrë të paanshme të vlerësojë çdo lloj informacioni mbi çështjet që trajton, në mënyrë që të arrijë në përfundimet e duhura.

Neni 8
Konfidencialiteti

1. I punësuarri ruan dhe garanton konfidencialitetin e informacioneve të klasifikuara dhe të të dhënave personale, me të cilat është njohur gjatë ushtrimit të funksionit të tij, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. I punësuarri respekton konfidencialitetin e diskutimeve të zhvilluara gjatë veprimtarisë në IAP.

Neni 9
Transparenca

I punësuarri duhet t'i kryejë detyrat e tij në mënyrë transparente. Ai duhet ta ruajë konfidencialitetin e informacionit që ka, sipas legjislacionit në fuqi.

KAPITULLI II
Rregullat e mirësjelljes gjatë procesit të punës

Neni 10
Mirësjellja e të punësuarve

1. I punësuarri në punën e tij udhëhiqet nga parimet, por pa u kufizuar në parimin e integritetit, të ligjshmërisë, të paanshmërisë dhe pavarësisë, të konfidencialitetit dhe transparencës.
2. I punësuarri duhet t'i kryejë punët dhe detyrat në mënyrë të drejtë dhe efikase.
3. I punësuarri duhet t'i shfrytëzojë pasurinë publike financiare dhe jofinanciare, në mënyrë të drejtë dhe të mos i keqpërdor ato.
4. I punësuarri, në asnjë mënyrë, nuk duhet ta keqpërdor pozitën e tij zyrtare për interesin e tij personal apo për interesin e dikujt tjetër.
5. I punësuarri gjatë ushtrimit të detyrës së tij duhet ta ruajë autoritetin e IAP-së.
6. I punësuarri ushtron detyrat e tij në mënyrë profesionale, me përgjegjësi dhe i pavarur, pa u ndikuar nga të tjerët.
7. I punësuarri gjatë ushtrimit të detyrës, reciprokisht, duhet të sillet me mirësjellje, pa marrë parasysh nacionalitetin, bindjen fetare, politike, gjininë, gjendjen shëndetësore dhe familjare.
8. I punësuarri duhet ta respektojë punën e tjetrit dhe të bashkëpunojë në mënyrë që ta ngriejë efikasitetin dhe cilësinë në punë.
9. I punësuarri duhet të ketë kujdes të mos i pengojë kolegët në kryerjen e detyrave të punës.
10. I punësuarri nuk duhet ta shprehë kureshtjen për çështjet që nuk i përkasin dhe nuk duhet t'i komentojë sjelljet e kolegëve.
11. Qasja ndaj kolegëve në punë duhet të jetë e përgjegjshme dhe profesionale.

12. Marrëdhëniet ndërmjet të punësuarve duhet të bazohet në respektin e ndërsjellë, si dhe në ruajtjen e dinjitetit dhe të personalitetit.
13. I punësuar nuk duhet t'i shprehë qëndrimet zyrtare në lidhje me çështjet që janë në proces të shqyrtimit në IAP.

Neni 11

Masat mbrojtëse

1. Nëse i punësuar konsideron se nga ai kërkohet të veprojë në kundërshtim me ligjin, shkeljet e këtilla duhet të paraqiten tek organi kompetent, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. I punësuar duhet të përmbahet prej situatave që në çfarëdo mënyre pengon marrjen e vendimeve të drejta dhe efikase e që kanë të bëjnë me punën dhe mandatin e IAP-së.

Neni 12

Veshja dhe paraqitja në punë

Veshja dhe paraqitja e të punësuarit në punë duhet të jetë e përshtatshme, për ta përfaqësuar sa më denjësisht institucionin, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 13

Sjellja me qytetarët

1. I punësuar ka për detyrë të presë me mirësjellje çdo qytetar, duhet të komunikojë dhe t'u përgjigjet me etikë profesionale ankesave të qytetarëve, në mënyrë që ta ruajë dhe ta respektojë dinjitetin dhe personalitetin e tij.
2. I punësuar nuk duhet të tërhiqet për shkak të frikës, presionit apo vështirësisë që mund të ballafaqohet gjatë ushtrimit të funksionit.
3. Rregullat e këtij neni vlejné përshtatshmërisht edhe për të punësuarit e tjerë, të cilët nuk merren me ankesat e qytetarëve, por në forma të tjera kanë komunikim me ta.

Neni 14

Ruajtja e fshehtësisë zyrtare

1. I punësuar është i detyruar ta ruajë fshehtësinë zyrtare, në pajtim me ligjin dhe me aktet e brendshme të IAP-së.
2. I punësuarit duhet ta sigurojë ruajtjen e fshehtësisë me organizimin e punës në zyrën e tij, e në veçanti lidhur me korrespondencën të cilën e mban me të tjerët.

Neni 15

Parandalimi dhe shmangia e konfliktit të interesit

1. I punësuar i gjatë ushtrimit të funksionit të tij duhet të veprojë në mbrojtje të interesit publik dhe nuk ka të drejtë që interesin e tij privat ta vërë para interesit publik.
2. Për shmangien e konfliktit të interesit, i punësuar duhet të veprojë sipas dispozitave të Ligjit përkatës për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.
3. Udhëheqësi i drejtpërdrejtë, në bazë të të dhënave që ka në dispozicion, duhet t'i ndërmarrë masat e nevojshme që të shmangët caktimi ose zgjedhja e një personi në pozicione në të cilat mund të lindë ose ka konflikt të interesit, sipas dispozitave të Ligjit përkatës për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Neni 16

Dhuratat, favorët dhe përfitimet e tjera

1. I punësuar nuk mund të pranojë dhurata apo favore të tjera për vete dhe as për anëtarët e familjes, që kanë të bëjnë me ushtrimin e detyrave zyrtare, përveç dhuratave protokollare ose të rastit, në pajtim me ligjin.
2. Dhurata protokollare konsiderohen dhuratat e sjella nga përfaqësuesit e vendeve të huaja dhe nga organizatat ndërkombëtare gjatë vizitave dhe rasteve të tjera, apo dhuratat e sjella në kushte të ngjashme.
3. Nëse dhurata e rastit nuk është e karakterit personal, ajo menjëherë bëhet pronë e institucionit punëdhënës.
4. I punësuar nuk mund të pranojë dhurata monetare.
5. Çdo dhuratë e pranuar nga i punësuar duhet të paraqitet dhe të regjistrohet te zyrtari përgjegjës i institucionit punëdhënës, i cili është i ngarkuar për regjistrimin e dhuratave.
6. Në të gjitha rrethanat e pranimit të dhuratave, duhet të vepruhet sipas ligjit.

Neni 17

Abuzimi me detyrën

1. I punësuar nuk duhet ta përdorë autoritetin që i është dhënë atij, sidomos për të bërë favore apo privilegje për kolegët, për qytetarët apo për grupet e ndryshme, për përfitime financiare, politike, seksuale apo ndonjë përfitim tjetër. Gjithashtu, ai/ajo nuk mund të bëjë premtime private në emër të institucionit të cilin e përfaqëson.
2. I punësuar nuk duhet ta përdorë, apo të lejojë persona të lidhur me të, në çfarëdo mënyre, detyrën e tij zyrtare, në mënyrë të tillë që të nxisë apo të detyrojë një person tjetër, përfshirë dhe vartësit, për ndonjë përfitim financiar apo çdo lloj përfitimi tjetër për interesa personale.

Neni 18

Pjesëmarrja në organizata dhe puna jashtë IAP-së

1. Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij nuk mund të kenë marrëdhënie tjetër punësimi, me apo pa shpërblim, në subjektet publike, private dhe as në organizata jofitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies, të drejtës së autorit, të veprimtarive kulturore dhe dhënies së leksioneve.
2. I punësuar në IAP mund të ushtrojë veprimtari të tjera, jashtë orarit të punës, të cilat nuk cenojnë pavarësinë profesionale dhe paanshmërinë. Posaçërisht, të punësuarit i ndalohe të marrë pjesë apo të punojë në ndonjë organizatë që mbështet çfarëdo diskriminimi dhe kufizimi të të drejtave dhe të lirive të njeriut.
3. Nëse ka dyshime, që një aktivitet mund të jetë në kundërshtim me parimet e sipërpërmendura, i punësuar duhet të konsultohet me mbikëqyrësin e tij.

Neni 19

Përdorimi i pronës së institucionit

I punësuar duhet ta mbrojë dhe ta ruajë pronën e IAP-së, përfshirë këtu dhe dokumentacionin zyrtar dhe ta përdorë atë për qëllime të kryerjes së detyrave dhe përgjegjësisë, të cilat i ngarkohen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Çdo i punësuar duhet t'i përdorë mjetet që ofron pozicioni i punës, vetëm për realizimin e detyrave të tij dhe jo për qëllime personale.

KAPITULLI III

Sjelljet brenda dhe jashtë institucionit

Neni 20

Sjellja me mbikëqyrësin

1. I punësuar, me mirësjellje, duhet t'i paraqesë mbikëqyrësit informacione mbi çështjen në kompetencën e tij dhe t'i shprehë mendimet e tij mbi trajtimin e çështjeve të ndryshme.
2. I punësuar duhet t'i zbatojë politikën e veprimit të udhëheqësve drejtues dhe sjellja e tij duhet të jetë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi.
3. I punësuar duhet t'i paraqesë problemet që shfaqen gjatë ushtrimit të detyrës dhe të diskutojë për gjetjen e zgjidhjeve më efektive me udhëheqësin e drejtpërdrejtë.

Neni 21

Sjellja me vartësin

1. Udhëheqësi duhet të jetë shembull i sjelljes për vartësit e tij, t'i respektojë e t'i dëgjojë mendimet dhe pikëpamjet e vartësve të tij, ta promovojë bashkëpunimin, gjithnjë duke mbajtur përgjegjësi për vendimin final.

2. Udhëheqësi duhet ta mbikëqyrë punën e vartësve të tij, të marrë përgjegjësi për veprimet dhe për gabimet e tyre, si dhe t'i njoh dhe t'i mbrojë të drejtat e vartësve të tij.
3. Udhëheqësi është i obliguar që me kujdes, në pajtim me ligjin dhe me aktet nënligjore, t'ua ndajë punët vartësve të tij, ta mbikëqyrë punën e tyre, të kujdeset për statusin e tyre, e në veçanti në kryerjen e punëve dhe të sjelljes me palët.
4. Udhëheqësi duhet t'i udhëzojë dhe t'i njoftojë vartësit e tij me parimet e këtij Kodi.
5. Udhëheqësi duhet t'u sigurojë vartësve të tij kushte adekuate për punë dhe aftësim profesional dhe status legjitim të të punësuarit, në pajtim me ligjin.
6. Udhëheqësi është i obliguar që vartësve të tij t'ua bëjë me dije për obligimin për veshjen e përshtatshme gjatë kohës së punës e në veçanti për sjellje të kulturuar dhe të dëshirueshme me palët.
7. Udhëheqësi duhet ta respektojë dinjitetin, personalitetin, idetë dhe iniciativat, si dhe ta nxisë bashkëpunimin e stafit që udhëheq, njëkohësisht ta ruajë të drejtën për vendimmarrje.
8. Udhëheqësi duhet t'i motivojë vartësit e tij në kryerjen e detyrave me profesionalizëm, respektim reciprok, marrëdhënie të mirë bashkëpunimi dhe të jetë shembull i mirë për të tjerët.
9. Udhëheqësi duhet t'i mbrojë të drejtat e vartësve të tij dhe në asnjë mënyrë nuk i lejohet t'i shkelë dhe as t'i kufizojë të drejtat e tyre.
10. Udhëheqësi duhet ta vlerësojë në mënyrë të barabartë, objektive dhe efikase sjelljen e vartësve të tij dhe të mos e favorizojë ndonjërin prej tyre.
11. Udhëheqësi duhet t'u ofrojë vartësve të tij mundësi të barabarta të zhvillimit të karrierës, të ngritjes profesionale dhe motivim në punë.

Neni 22

Sjellja me kolegët

1. I punësuar duhet të sillet në mënyrë kolegjiale, me respekt dhe të mos komentojë për profesionalizmin, ndërgjegjen, efikasitetin, jetën personale (private) apo dinjitetin e tyre.
2. I punësuar duhet të tregojë sjellje të mirë, bazuar në mirëkuptim, respektim reciprok e solidaritet dhe të ketë frymë bashkëpunimi në praktikat e në veprimet e përditshme, për ta realizuar misionin e institucionit. Ai, me kolegët e tij, duhet të sillet me mirësjellje e ndershmëri, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, bindjen fetare, seksin, statusin familjar, gjendjen shëndetësore apo çfarëdo rrethane tjetër.
3. I punësuar duhet ta respektojë punën e kryer nga të tjerët dhe të mos e fshehtë apo minimizojë efikasitetin, por t'i mbështesë, t'i ndihmojë dhe të ofrojë bashkëpunim me njohuritë dhe eksperiencën e vet.

Neni 23

Deklarimi apo denoncimi i rrejtshëm

Deklarimi apo denoncimi i rrejtshëm është i ndëshkueshëm me rregullat e brendshme të IAP-së.

Neni 24

Ngacmimi seksual

1. Ngacmimi seksual nënkupton çilëndo formë të sjelljes së padëshiruar verbale, joverbale ose fizike të natyrës seksuale, me qëllim të cenimit të dinjitetit apo që cenon dinjitetin e personit dhe krijon një mjedis i cili është objektivisht frikësues, armiqësor, degradues ose poshtërues.
2. Ngacmimi seksual është veprë penale e dënueshme sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.
3. Përgjegjësia penale sipas paragrafit 2 nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore në IAP.

Neni 25

Sjellja me institucionet dhe shoqërinë civile

1. I punësuar duhet ta promovojë bashkëpunimin në fushat që lidhen me misionin e IAP-së, me të gjitha autoritetet publike, me organizatat ndërkombëtare, me shoqërinë civile brenda dhe jashtë vendit.
2. I punësuar duhet ta promovojë bashkëpunimin me institucionet edukative dhe shkencore, në fushat që lidhen me misionin e IAP-së, duke u dhënë informacione dhe duke lehtësuar me çdo mënyrë bashkëpunimin me ta.
3. I punësuar nuk mund të bëjë asnjë lloj premtimi e as nuk mund ta përfaqësojë institucionin, pa marrë leje paraprakisht nga mbikëqyrësi.
4. I punësuar duhet ta përfaqësojë me dinjitet IAP-në, në takime, në ngjarje, në organizata ndërkombëtare, në institucione edukative, në konferenca etj., duke respektuar rendin juridik të Republikës së Kosovës.
5. I punësuar, kur e përfaqëson institucionin në takime, në grupe punuese apo në komisione, duhet ta shprehë mendimin apo qëndrimin e institucionit dhe jo atë personal.

Neni 26

Sjellja me media

1. I punësuar nuk mund të bëjë deklaratat publike dhe të japë informata dhe dokumente të tjera nëse nuk ka marrë më parë aprovimin nga mbikëqyrësi.
2. I punësuar nuk duhet t'i zbulojë informatat konfidenciale në lidhje me punën, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. Të punësuarit, gjatë dhënies së deklaratave publike, në asnjë mënyrë nuk i lejohe të japë informata të pasakta dhe mendime personale në lidhje me çështjet.

Neni 27
Zbatimi i Kodit

1. I punësuarit duhet ta zbatojë në përpikëri këtë Kod.
2. Udhëheqësi i drejtpërdrejtë ka përgjegjësi të kontrollojë nëse i punësuarit po i zbaton rregullat e përcaktuara në këtë Kod dhe të propozojë ose t'i ndërmarrë masat e duhura disiplinore për shkeljet e tij.
3. Për shkeljen e rregullave të parapara në këtë Kod, kur ato nuk përbëjnë vepër penale, zbatohen masat disiplinore në pajtim me legjisllacionin në fuqi.
4. Njësia e Personelit i njofton të punësuarit për Kodin e Etikës të IAP-së.

Neni 28
Dispozita shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi, shfuqizohet: Kodi i Etikës i Institucionit të Avokatit të Popullit, Vendimi nr.03/2011, i datës 26 prill 2011.

Neni 29
Hyrja në fuqi

Ky Kod i Etikës hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Prishtinë, 11 shtator 2023

Naim Qelaj
Avokat i Popullit

